

PLANI STRATEGJIK 2018 – 2022

Qershor, 2018

Përmbajtja:

1. Akronimet dhe Shkurtesat:	3
2. Hyrje	4
3. Rreth Organizatës	5
Historiku	5
Vizioni	6
Misioni	6
Objektivat Strategjike	6
4. Analizë e Situatës të Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë	7
Arsimimi	7
Jeta e pavarur dhe përfshirja në shoqëri	8
Punësimi	9
Shërbimet shëndetësore dhe sociale	10
5. SWOT Analiza e Handikos Ferizaj	11
6. Objektivat Strategjike	13
I. Përmirësimi i politikave publike dhe rritja e zbatimit të ligjeve relevante	13
II. Rritja e cilësisë dhe zgjerimi i shërbimeve të ofruara me bazë në komunitet	14
III. Rritja e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuar në tregun e punës	15
7. Qëndrueshmëria Financiare	16
8. Monitorimi dhe Vlerësimi	17
9. Rritja e vizibilitetit	17
10. Infrastruktura	18
11. Korniza Ligjore	19

1. Akronimet dhe Shkurtesat:

ATRC	Advocacy and Training Resource Center
HF	Handikos Ferizaj
ISSH	Instituti Special Shtime
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
USAID	United States Agency for International Development

2. Hyrje

Ky dokument paraqet planin strategjik të Handikos Ferizaj për periudhën 2018-2022. Plani është hartuar duke u bazuar në diskutimet e zhvilluara gjatë punëtorisë dy-ditore të mbajtur në maj të vitit 2018 ku morën pjesë anëtarë të bordit, menaxhmenti, stafi i organizatës, bashkëpunëtorë dhe anëtarë nga komuniteti i personave me aftësi të kufizuara.

Ky plan do të shërbejë si udhëzues për organizatën dhe palët e afërta të interesit në aspektin e drejtimeve strategjike dhe hapave konkretë që duhet ndërmarrë gjatë 5 viteve të ardhshme për të kontribuar në përmbushjen e vizionit dhe misionit të organizatës. Këtij plani strategjik i bashkëngjitet edhe plani i punës dhe buxheti.

Handikos Ferizaj dëshiron të falënderojë të gjithë pjesëmarrësit në procesin e planifikimit strategjik, të cilët përmes kontributeve të tyre mundësuan zhvillimin dhe përpilimin e këtij plani. Gjithashtu, jemi mirënjohës ndaj USAID-it dhe ATRC-së për mbështetjen e dhënë financiare dhe teknike në realizimin e këtij plani.

3. Rreth Organizatës

Handikos Ferizaj është organizatë jo-qeveritare e përkushtuar në rritjen e mirëqenies dhe pavarësimin e personave me aftësi të kufizuar, përmes ofrimit të shërbimeve sociale dhe avokimit.

Handikos Ferizaj punon për së afërmi me komunitetin, organizata të tjera si-motra, institucionet shëndetësore dhe autoritetet lokale e qendrore, për t'i shërbyer në mënyrë sa më efektive dhe të qëndrueshme përfituesve të saj.

Historiku

Handikos Ferizaj ka qenë pjesë e HANDIKOS-it e cila është themeluar në vitin 1983 dhe që fillimisht ka qenë e emëruar si Shoqata e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve e Kosovës. Gjatë fazës emergjente të pas-luftës, HANDIKOS-i është shndërruar në ofrues të shërbimeve duke tentuar të mbulojë disa nga nevojat e personave me aftësi të kufizuar. Me këtë rast, HANDIKOS ka ofruar materiale ortopedike, sanitare dhe materiale për parandalimin e plagëve dekubitare. HANDIKOS ka vepruar në tërë Kosovën dhe ka ofruar shërbimet e njëjta për të gjitha komunitetet pa dallim etnie, feje dhe race.

Dega në Ferizaj, së bashku me të gjitha degët e tjera të HANDIKOS-it, që nga viti 2015 është pavarësuar në aspektin administrativ e programor nga qendra në Prishtinë dhe tani është e regjistruar si OJQ në vete. Kjo shkëputje është bërë me planifikim paraprak me qëllim të forcimit organizativ të qendrave gjithandej Kosovës, rritjes së qëndrueshmërisë së shërbimeve të ofruara me bazë në komunitet dhe përmbushjes së nevojave të përfituesve në mënyrë më efikase.

Vizioni

Shoqëri gjithëpërfshirëse me njohje dhe realizim të plotë të të drejtave dhe mundësive të barabarta të personave me aftësi të kufizuara.

Misioni

Handikos Ferizaj është organizatë jo-qeveritare që punon në rritjen e mirëqenies dhe pavarësimin e personave me aftësi të kufizuara, përmes avokimit dhe ofrimit të shërbimeve sociale.

Objektivat Strategjike

Duke u bazuar në analizën e situatës së personave me aftësi të kufizuara, Handikos Ferizaj e sheh si të nevojshme që organizata të përqendrohet në tri objektiva kryesore strategjike. Këto tri objektiva janë:

1. Përmirësimi i politikave publike dhe rritja e zbatimit të ligjeve e strategjive relevante për personat me aftësi të kufizuara.
2. Rritja e cilësisë dhe njehërit zgjerimi i shërbimeve të ofruara me bazë në komunitet.
3. Rritja e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës.

4. Analizë e Situatës të Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë

Integrimi në shoqëri i personave me aftësi të kufizuara mbetet një sfidë për shtetin dhe shoqërinë e Kosovës. Në mungesë të të dhënave të sakta, llogaritet përafërsisht se numri i përgjithshëm i personave me aftësi të kufizuara në Kosovë është diku rreth 150,000 ose 7% e popullsisë. Ka pasur një progres të vogël në dekadën e fundit në realizimin e të drejtave të këtyre personave, kjo për shkak të mbështetjes së kufizuar, shërbimeve jo-adekuate shëndetësore, si dhe qasshmërisë së dobët në shërbimet ekzistuese¹.

Në këtë aspekt, ka pak dallime mes qendrave të ndryshme të Kosovës, edhe pse duhet cekë se kryeqendra gëzon një përparësi të lehtë për shkak të numrit më të madh të OJQ-ve që ofrojnë shërbime për këtë komunitet. Gjithashtu, mundësitë për punësim dhe arsimim mund të jenë pak më të mëdha për shkak të koncentrimit më të madh të bizneseve dhe institucioneve arsimore. Ferizaji meqenëse është afër Prishtinës, gjithashtu përfiton në këtë aspekt. Megjithatë, lëvizja pa pengesa dhe në mënyrë të pavarur vazhdon të jetë problematike qoftë edhe në distanca të shkurta.

Kjo analizë shqyrton shkurtimisht situatën në nivel të Kosovës duke u përqendruar konkretisht në fushën e arsimit, punësimit, të drejtën në jetë të pavarur dhe ofrim të shërbimeve. Si e tillë, kjo analizë nuk i shtjellon të gjitha çështjet që i prekin personat me aftësi të kufizuara, mirëpo tenton të ofrojë një pasqyrë të shkurtë të gjendjes aktuale në disa nga fushat kryesore.

Arsimimi

Sipas raportit të Komisionit Evropian për Kosovë, ka pasur një rritje të numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara që janë de-institucionalizuar për të ndjekur shkollat e rregullta (qoftë në klasa të bashkangjitura apo të rregullta) në Kosovë. Gjatë periudhës 2013-14, 45% e fëmijëve me aftësi të kufizuara të moshës fillore dhe të mesme të ulët kanë vijuar shkollën, ndërsa shkollën e mesme dhe të lartë e kanë vijuar rreth 18%. Sipas të njëjtit raport, ka nevojë urgjente për trajnimin e mësimitdhënësve dhe asistentëve personal në mënyrë që të ofrohet një arsim cilësor për këta fëmijë.

Megjithatë, duhet cekur se mbledhja e të dhënave është problematike dhe se ende nuk ka informata të sakta rreth numrit të fëmijëve që janë brenda shkollave të rregullta si dhe fëmijëve që nuk janë fare të kyçur në arsim. Kjo përbën një problem në vetvete. Sipas Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë kategorizimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara është bërë nga drejtorët e shkollave të cilët nuk janë të trajnuar për të bërë këtë gjë. Si pasojë, fëmijët pa aftësi të kufizuara janë të përfshirë në këtë grup, si p.sh janë raportuar raste të fëmijëve të cilët mbajnë syze si fëmijë me aftësi të kufizuara. Numri i përgjithshëm i fëmijëve me aftësi të kufizuara është i besueshëm vetëm për

¹ Raporti i Progresit për Kosovën 2018 - Komisioni Evropian

qendrat burimore, meqë ekipi i edukimit gjithëpërfshirës mbikëqyr mbledhjen e të dhënave². Gjatë viteve të fundit po punohet me shkolla për vendosjen e kriterëve të qarta për përcaktimin e asaj që njihet si nevojë e veçantë dhe aftësi e kufizuar, gjë që do të ndihmonte në të ardhmen në ofrimin e të dhënave më të sakta.

Sa i përket kompetencave, komunat janë përgjegjëse për sigurimin e transportit për fëmijët me aftësi të kufizuara në shkolla dhe ofrimin e mbështetjes sipas nevojave të tyre individuale. Kjo vlen si për shkollat e rregullta ashtu dhe për qendrat burimore. Megjithatë fëmijët ballafaqohen me një sërë sfidash, duke përfshirë këtu infrastrukturën jo-adekuate, mungesën e asistentëve personal, mungesën e mbështetjes nga shumë mësues, si dhe në raste të shumta, mungesën e planeve individuale të edukimit.

Jeta e pavarur dhe përfshirja në shoqëri

Njerëzit me aftësi të kufizuara përballen me pengesa të shumta në integrimin e tyre në shoqëri. Një nga pengesat kryesore vazhdon të jetë mungesa e madhe e qasjes në hapësira dhe institucione publike - përfshirë këtu institucionet arsimore, shëndetësore, gjykata, prokurori, polici, transport publik, rrugë etj. Kjo i pengon personat me aftësi të kufizuara të jenë pjesëmarrës të pavarur dhe aktiv në shoqëri. Përkundër përpjekjeve për të përmirësuar qasjen në infrastrukturë fizike dhe garancive ligjore, rezultatet e tanishme janë të kufizuara. Sipas një auditimi të ndërmarrë nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, masat e ndërmarra kanë qenë të rastësishme dhe pa priorizim, gjë që nuk ka ndihmuar në zgjedhjen e problemeve. Ky raport nxjerr si përfundim se objektivat e parapara në Strategjinë dhe Planin e Veprimit për personat me aftësi të kufizuara janë përmbushur në masë të ulët, sa i përket qasjes në hapësira dhe institucione publike³.

Sa i përket personave me aftësi të kufizuara intelektuale, Qeveria e Kosovës që moti është zotuar të përfundojë procesin e de-institucionalizimit, duke zhvendosur banorët nga Instituti Special në Shtime. Megjithatë, ISSH vazhdon të operojë pa shenja të dukshme të aktiviteteve që mund të çojnë në mbylljen e saj në të ardhmen e afërt. Në anën tjetër, vëzhgimet në terren tregojnë se banorët e këtyre shtëpive të bazuara në komunitet nuk janë të angazhuar drejtpërdrejt në jetën shoqërore dhe se nuk po ndihmohen drejt jetesës së pavarur. Përkundrazi, ata mbikëqyren drejtpërdrejt, me pak mundësi për integrim në komunitet në të ardhmen. Në fakt, mënyra e tyre e jetesës është mjaft e ngjashme me mënyrën se si kanë jetuar në ISSH. Së fundi, stafi i

²OpenEMIS Kosovë - Raport mbi misionin e fushëveprimit; Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Nëntor 2017

³ Raport i Auditimit: *Qasja për Personat me Aftësi të Kufizuara Fizike*; Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Nëntor 2015; Nr. i Dokumentit: 21X;22X.9-2013/15-08

punësuar në këto shtëpi ka treguar mungesë empatije dhe përkushtim për ruajtjen e të drejtave dhe dinjitetit të banorëve⁴.

Punësimi

Nuk ka të dhëna zyrtare nga MPMS-ja rreth numrit të të punësuarve, mirëpo sipas të dhënave të OJQ-ve që punojnë në këtë fushë ky numër është simbolik.

Problemi i punësimit të personave me aftësi të kufizuara ndërlidhet ngushtë me arsimin, zhvillimin ekonomik, ngritjen e vetëdijes dhe heqjen e paragjytimeve tek shoqëria rreth aftësive që posedojnë ata. Sa i përket arsimit, përveç problemeve të cilat u shtjelluan më lartë, gjithashtu duhet shtuar edhe shpërputhjen mes nevojave të tregut dhe mundësive për aftësim të ofruara nga institucionet arsimore në Kosovë.

Në aspektin e zhvillimit ekonomik, ndonëse sipas të dhënave të Bankës Botërore Kosova ka një rritje prej 3.9 për qind, kjo nuk është e mjaftueshme për të ulur dukshëm nivelet e larta të papunësisë, veçanërisht tek gratë, të rinjtë dhe komuniteti i personave me aftësi të kufizuara të cilët më së shumti janë të prekur; kjo në kombinim me planifikimin e dobët të buxhetit shtetëror dhe ligjeve jo-favorizuese për financim të OJQ-ve, e bën situatën edhe më të vështirë për këtë komunitet. Sa i përket ndërgjegjësimin, ka pasur iniciativa të shumta nga sektori jo-qeveritar në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe institucionet e Kosovës, të cilat kanë arritur të kontribuojnë në këtë drejtim. Një nga këto iniciativa është edhe punësimi i mbështetur, që zbatohet nga Handikos Ferizaj së bashku me partnerë të tjerë. Punësimi i mbështetur është një metodologji për të punuar me njerëzit me aftësi të kufizuara dhe grupe të tjera në disavantazh, që ju ndihmon të hyjnë dhe të mbajnë punësimin me pagesë në tregun e hapur të punës. Kjo metodë e punës është një politikë pro-aktive në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara⁵.

Sipas ligjeve në fuqi, organet e administratës shtetërore, punëdhënësit e sektorit privat dhe publik, si dhe organizatat jo-qeveritare, të gjithë janë të obliguar që me kushtet e përshtatshme të punës t'i punësojnë personat me aftësi të kufizuara. Sipas Ligjit për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara secili punëdhënës është i obliguar të punësojë një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë punëtorë. Në të kundërtën, punëdhënësi i cili nuk i përmbushë detyrimet, obligohet të paguajë në buxhetin e Kosovës kontributet mujore prej një për qind të shumës së pages minimale. Megjithatë, në realitet niveli i zbatimit të këtyre ligjeve është i ulët.

⁴ Practicing Universality of Rights: Analysis of the Implementation of the UN Convention on the Rights of Persons with Disabilities in View of Persons with Intellectual Disabilities in Bosnia and Herzegovina, Kosovo, Serbia.

⁵ Udhëzuesi i Shoqatës Evropiane për Punësim të Mbështetur – European Union of Supported Employment.

Problemi i punësimit kërkon një qasje dhe koordinim shumëpalësh e që fillon me angazhimin maksimal nga ana e qeverisë qendrore dhe komunave në zbatimin e ligjeve e strategjive aktuale si dhe favorizimin e politikave adekuate për zhvillim ekonomik.

Shërbimet shëndetësore dhe sociale

Megjithëse një pjesë e konsiderueshme e kujdesit për personat me aftësi të kufizuara organizohet përmes një rrjeti shërbimesh të bazuar në komunitet, hulumtimet kanë treguar se kujdesi institucional, sidomos për personat me aftësi të kufizuara intelektuale, vazhdon të luajë një rol dominues. Institucionet qeveritare, deri më tani, nuk kanë qenë të suksesshme në promovimin e konceptit të shërbimit me bazë në komunitet, pra zgjerimin e shërbimeve të institucioneve në komunitetin lokal përmes angazhimit të shoqërisë dhe ndërtimit të një ndjenjës së besueshmërisë e bashkëpunimit.

Organizatat jo-qeveritare si HANDIKOS-i janë ato të cilat përpiqen të ofrojnë shërbime dhe të konsolidojnë operacionet e tyre, mirëpo përballen me kapacitete të kufizuara. Gjithashtu duhet pasur parasysh se aktivitetet e OJQ-ve nuk mjaftojnë: ato nuk veprojnë në gjithë Kosovën dhe nuk mund të marrin përsipër barrën e ofrimit të të gjitha shërbimeve.

Ministria e Shëndetësisë, përmes institucioneve shëndetësore, ofron vetëm mjekimet shëndetësore bazë, dhe nuk mbulon shërbimet sociale dhe medikamentet specifike të cilat janë më se të nevojshme në trajtimin e pasojave që shkaktohen nga aftësia e kufizuar. Këto shërbime dhe ofrimi i barnave akoma nuk janë të rregulluara përmes një ligji të veçantë. Rehabilitimi shëndetësor, monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes shëndetësore dhe pajisja me medikamentet e nevojshme janë disa nga shërbimet të cilat do të përmirësonin gjendjen shëndetësore të personave me aftësi të kufizuara dhe do të lehtësonin pasojat e tyre.

Gjithashtu, stafi mjekësor ka nivel të ulët të njohurive mbi llojet e aftësive të kufizuara, gjenezën e tyre dhe pasojat që secila shkakton tek personat. Kjo rezulton rregullisht në një qasje jo-adekuate ndaj pacientëve, me ç ‘rast aftësisë së kufizuar i atribuohet çdo simptomë apo lloj sëmundjeje.

5. SWOT Analiza e Handikos Ferizaj

Analiza SWOT ka pas për qëllim të nxjerrë në pah anët e forta, të dobëta, mundësitë dhe rreziqet që i kanosen organizatës. **Sa i përket anëve të forta**, Handikos Ferizaj është një organizatë me përvojë shumë-vjeçare dhe referente në fushën e aftësisë së kufizuar për rajonin e Ferizajit. Ka një staf dhe menaxhment të dedikuar që e shohin punën në organizatë si një kauzë për të cilën punojnë me zell dhe gjithmonë të hapur ndaj ideve të reja.

Organizata ka raporte të mira me qeverinë lokale dhe institucione të tjera publike, gjë që ndihmon në kryerjen e punës më me efikasitetit. Ky bashëpunim vie në pah sidomos gjatë referimit të rasteve, identifikimit dhe intervenimit të hershëm tek fëmijët. Gjithashtu, të qenurit pjesë e rrjetit të HANDIKOS-it, është një përparësi që i ofron mundësi organizatës të ketë shtrirje më të gjerë, qasje në organet qeverisëse të nivelit qendror dhe qasje në resurse në formë të ekspertizës. Është një prej subjekteve të vetme, përfshirë këtu qeverinë lokale, që posedon bazë të të dhënave statistikore për personat me aftësi të kufizuara në komunën ku veprojnë. Handikos Ferizaj është një prej organizatave më të vjetra që ofron shërbime për të gjitha personat me aftësi të kufizuara në komunën e Ferizajit dhe kjo e vë atë në një pozitë mjaft të favorshme.

Sa i përket anëve të dobëta, Handikos Ferizaj është e vetëdijshme se pikësëpari organizatës i mungon një plan afatgjatë dhe qëndrueshmëria financiare. Mbijetesa e organizatës varet nga një projekt në tjetrin, zakonisht me planifikime ad-hoc dhe varsisht nga thirrjet për aplikim nga donatorët. Kjo mënyrë e veprimit jo gjithmonë plotëson nevojat e përfituesve dhe është jo-konsistente. Fondet e pakëta janë gjithashtu rezultat i mungesës të burimeve njerzore, sidomos personave të profilizuar në shkrim të projekteve dhe grumbullim të fondeve. Organizatës i mungon një sistem i mirëfilltë i monitorimit dhe vlerësimit të punës së tyre që do t'ju lejonte të bënë planifikim më të mirë të programeve, që është i bazuar në të dhëna të sakta rreth prioritetëve e nevojave të përfituesve. Meqenëse organizata punon për t'i shërbyer të gjithë personave me aftësi të kufizuara, pavarësisht moshës së tyre, atëherë duhet bërë përpjekje më të madhe të përfshirjes të të rriturve në programet e tyre. Në aspektin e infrastrukturës, HF-ja duhet të rregulloj çështjen e hapësirës për zyre dhe zhvillim të aktiviteteve, pasi që objekti aktual është në kontest pronësor mes komunës dhe Agjencionit për Privatizim. Mirëmbajtja e rregullt e objektit është një problem tjetër që duhet zgjidhë urgjentisht. Arkivimi i dosjeve personale të përfituesve duhet mirëmbajtur në kushte të duhura fizike dhe sipas normativave ligjore.

Në raport me jashtë, HF-ja edhe pse është aktive në rrjete sociale, duhet të punoj më shumë në rritjen e vizibilitetit (dukshmërisë) të organizatës, sidomos tek donatorët potencial. Gjithashtu, bashkëpunimi dhe koordinimi me OSHC të tjera në Ferizaj është jo i kënaqshëm; ndër të tjera, kjo potencialisht e privon organizatën nga shumë mundësi rrjetëzimi dhe ndihme nga organizata të tjera.

Handikos Ferizaj ka mundësi të mira për zhvillim të mëtutjeshëm dhe të qëndrueshëm, duke pas parasysh imazhin e mirë që gëzon në shoqëri, përvojën shumëvjeçare, të vetmit në Ferizaj në ofrimin e shërbimeve sociale për të gjithë personat me aftësi të kufizuara dhe bashkëpunimin e mirë me qeveri lokale e institucione publike. Të gjitha këto elemente pozitive formojnë një bazë të fortë që duhet shfrytëzuar për të ngritur qëndrueshmërinë financiare të organizatës. Kjo mund të bëhet përmes rritjes së bashkëpunimit me sektorin privat - sidomos prodhuesit lokal që janë të mbështetur nga donatorët, mirëpo jo vetëm ata - fushatave për ngritje të fondeve në mënyrë të rregullt dhe zhvillimit të programit për ndërmarrësi sociale. Gjithashtu, HF është në pozitë të mirë për tu zhvilluar në të ardhmen në qendër burimore, pjesë e së cilës do të ishte edhe qendra për aktivitete ditore, mirëpo një ndër kushtet elementare që duhet përmbushur paraprakisht është siguri i hapësirës. Për këtë arsye duhet bërë më shumë presion në Komunën e Ferizajit për sigurimin e një objekti. Duke qenë pjesë e rrjetit të organizatave "HANDIKOS" që kanë një shtrirje të gjerë, HF-ja është në pozitë shumë të mirë të jetë pjesë e projekteve që janë në nivel të Kosovës. Përveç asaj, të qenurit pjesë e një rrjeti të tillë gjithashtu do të thotë qasje në informata dhe ndihmë të ndërsjellë. HF ka mundësi të mira të angazhojë më shumë vullnetarë dhe jo vetëm nga Fakulteti i Psikologjisë, por edhe nga fusha të tjera që i nevojiten për zhvillim të organizatës, si administrim, komunikim dhe marketing, burime njerëzore etj. Së fundi, HF për shkak të raporteve të mira me qeveri lokale është në pozitë të mirë për tu inkuadruar edhe më tepër në politik bërje, vetëm apo në koalicion me organizata të tjera, për të ndikuar pozitivisht politikën që kanë të bëjnë me persona me aftësi të kufizuara.

Sa i përket rreziqeve të brendshme, një ndër kryesoret është qëndrueshmëria financiare, gjë që vën në pikëpyetje konsistencën në ofrimin e shërbimeve dhe përfundimisht përmbushjen e misionit të organizatës. Si pasojë e kësaj vjen edhe deri tek ikja e personelit, që kërkojnë një siguri më afatgjatë. Mungesa e personelit i dobëson kapacitetet edhe më shumë dhe pengon zhvillimin e organizatës. Egziston rreziku i zgjerimit të tepërt të kapaciteteve të organizatës, duke pas parasysh peshën e programeve të Handikos Ferizaj (avokimi, shërbimet sociale, qendra ditore, punësimi) që kërkojnë zotësi për tu implementuar dhe janë të ndryshme njëra nga tjera. Kjo mund të rezultojë me nivel jo të kënaqshëm në implementimin e projekteve, gjë që duhet evituar me çdo kusht.

Sa i përket rreziqeve të jashtme, ndërrimi i stafit politik nëpër institucione është një brengë serioze ngase rrezikon marrëdhëniet me përfaqësuesit e institucioneve. Përveq asaj, HF duhet të ketë kujdes të shtuar të mos perceptohet si OJQ që favorizohet nga një parti e caktuar. Për këtë arsye është me rëndësi kontakti i rregullt dhe në mënyrë të barabartë me të gjitha partitë politike, si ato në pozitë ashtu edhe ato në opozitë.

6. Objektivat Strategjike

1. Përmirësimi i politikave publike dhe rritja e zbatimit të ligjeve relevante për personat me aftësi të kufizuara

Zbatimi i ligjit vazhdon të jetë një nga problemet kryesore në Kosovë. Krahës kësaj, disa nga ligjet dhe politikat publike janë jo adekuate për personat me aftësi të kufizuara dhe paraqesin një pengesë tjetër drejt realizimit të të drejtave të tyre. Zbatimi i ligjit për persona për statusin e të drejtave të personave me paraplegji dhe tetraplegji është i kufizuar për shkak të mungesës të akteve nënligjore.

Handikos Ferizaj do të punoj në monitorimin e punës të komunës, institucioneve publike, si p.sh qerdhe, shkolla, spitale, etj, mirëpo edhe duke marrë pjesë në mënyrë aktive në formësimin e politikave dhe planifikim buxhetor, në mënyrë që këto të fundit të reflektojnë më mirë nevojat e personave me aftësi të kufizuara. Në koordinim me HANDIKOS-in në Prishtinë, sipas nevojës do të angazhohet edhe në nivel qendror. Konkretisht do të përqëndrohet në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe punësimit.

Krahës kësaj, analiza SWOT ka nxjerrë në pah nevojën për rritjen e bashkëpunimit me organizata të tjera të shoqërisë civile në Ferizaj dhe angazhimin më të madh të tyre në krijimin e sinergjive që do të ndihmonin në arritjen e qëllimeve të ndërsjella. Gjithashtu, ndërgjegjësimi i shoqërisë në tërësi mbetet një nevojë e padiskutueshme dhe është një nën-objektivë tërthore.

Nën-objektivat:

- 1.1 Monitorimi i punës së komunës dhe institucioneve publike.
- 1.2 Rritja e bashkëpunimit me organizata të tjera të shoqërisë civile.
- 1.3 Rritja e angazhimit të HF-së në politikë-bërje dhe planifikim buxhetor në nivel lokal.
- 1.4 Ndërgjegjësimi i shoqërisë mbi aftësinë e kufizuar.

2. Rritja e cilësisë dhe zgjerimi i shërbimeve të ofruara me bazë në komunitet.

Handikos Ferizaj do të vazhdon të ofroj shërbime sociale për anëtarët e saj dhe do të punoj në rritjen e cilësisë në mënyrë që t'ju përgjigjet sa më mirë nevojave të përfituesve. Këto shërbime përfshijnë vizitat në shtëpi, shkollë, puna me prindër dhe familjarë, aktivitetet didaktike për jetesë të pavarur, si dhe aktivitetet në kuadër të Qendrës Ditore, që do të vihet në funksion gjatë gjysmës së dytë të vitit 2018 në bashkëpunim me Save the Children.

Krahas shërbimeve që Handikos Ferizaji i ofron anëtarëve të saj, organizata do të punoj për së afërmi edhe me institucionet e tjera, parimisht ato shëndetësore dhe arsimore, për të përmirësuar mbrojtjen dhe kujdesin social të personave me aftësi të kufizuara; këtu përfshihet edhe zhvillimi i llojeve të tjera të shërbimeve, të nevojshme për Komunën e Ferizajt dhe ngritjen e kapaciteteve për ofrimin e tyre.

Handikos Ferizaji do të vendosë mekanizma të brendshëm (si p.sh vlerësimet nga përfituesit, auditim nga brenda dhe jashtë, etj.) për kontrollin e cilësisë së shërbimeve të ofruara dhe gjithashtu do t'i nënshtrohet licencimit nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Nën-objektivat:

- 2.1. Zhvillimi i programit të shërbimeve me bazë në shtëpi dhe komunitet.
- 2.2. Ngritja e koordinimit dhe bashkëpunimit me institucionet arsimore, shëndetësore dhe komunale për ofrim të shërbimeve.
- 2.3. Funksionalizimi i Qendrës Ditore.
- 2.4. Ngritja e kapaciteteve të organizatës dhe përcaktimi i standardeve të cilësisë të shërbimeve.

3. Rritja e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës

Objektiva e tretë i përkushtohet punësimit. Në këtë aspekt Handikos Ferizaj do të vazhdoj të ofron programin për punësim të mbështetur i cili ofrohet tani 4 vite dhe ka treguar rezultate pozitive. Njëkohësisht do të punoj në ngritjen e kapaciteteve të personave me aftësi të kufizuara duke mundësuar qasjen e tyre në arsim dhe aftësim profesional cilësor. Çfarëdo lloji i aftësimin profesional duhet të pasqyroj nevojat e tregut dhe trendet e fundit të teknologjisë, gjë që hapë shumë mundësi për personat me aftësi të kufizuara, si në mësim ashtu edhe në punësim.

Inicimi i programit për ndërmarrësi sociale është një ndër nën-objektivat e tjera që planifikon të ndjek Handikos Ferizaji për të ndihmuar punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Zhvillimi i një programi të tillë kërkon fillimisht studime paraprake të nevojave të tregut dhe mundësisë për furnizim të këtyre nevojave. Në këtë aspekt, përvoja e organizatave të tjera në ndërmarrësi sociale, siç është p.sh ajo e Down Syndrome Kosova, mund të jetë e dobishme.

Për të arritur qëllimet e saja, është fundamentale që Handikos Ferizaj të thelloj edhe më tutje bashkëpunimin ndër-institucional dhe ndër-sektorial, në mënyrë që të ketë një angazhim më të madh nga të gjitha palët në nivel lokal dhe qendror, dhe gjithmonë duke punuar në koordinim me qendrën HANDIKOS në Prishtinë e sipas nevojës edhe me qendrat e tjera.

Nën-objektivat:

- 3.1 Ofrimi i programit për punësim të mbështetur.
- 3.2 Rritja e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuar në arsim dhe aftësim profesional.
- 3.3 Ngritja e bashkëpunimit ndër-institucional (MPMS, Komuna, Qendra për Punësim, Qendra për Aftësim Profesional dhe Sektori Privat).
- 3.4 Inicimi i zhvillimit të programit për ndërmarrësi sociale.

7. Qëndrueshmëria Financiare

Për t'i arritur objektivat e saja strategjike, Handikos Ferizaj ka nevojë për burime financiare. Ngritja e fondeve është një nga prioritetet e organizatës. Fondet për OIQ-të janë në rënie e sipër në dekadën e fundit në Kosovë, mirëpo, ka ende shumë donatorë që veprojnë në nivel lokal. Në të njëjtën kohë, duhet cekë se ka pas rritje të financimit nga ana e Komisionit Evropian përmes instrumenteve të ndryshme të saja. Handikos Ferizaj ka përfituar dhe vazhdon të përfitoj nga shumë këta donatorë dhe do të jetë vazhdimisht në vëzhgim për mundësi të reja financimi. Në këtë aspekt rritja e vizibilitetit të punës së organizatës dhe kontakti sistematik me donatorët potencial është me rëndësi të madhe.

Përveç asaj, Handikos Ferizaj do të punoj në zgjerimin e të hyrave nga burime të ndryshme. Rritja e donacioneve nga sektori privat duhet rritur, meqenëse edhe mundësitë janë më të mëdha duke marrë parasysh zgjerimin e sektorit privat në krahasim me dekadën paraprake; edhe në këtë rast nevojitet një qasje sistematike dhe kreative nga ana e Handikos Ferizaj ndaj bizneseve lokale. Pikënisje e mirë janë bizneset të cilat kanë përfituar fonde nga donatorët e huaj në Kosovë. Këta të fundit vlerësojnë lartë ndihmën ndaj iniciativave lokale bamirëse të OIQ-ve dhe krijimin e sinergjive mes sektorit privat dhe atij të shoqërisë civile.

Gjithashtu duhet parë mundësitë për ngritjen e mbështetjes nga qeveria lokale. Handikos Ferizaj tanimë gëzon një mbështetje nga komuna e Ferizajit (qiraja dhe shpenzimet komunale), mirëpo në aspektin infrastrukturor duhet insistuar në zgjidhje afat-gjate që është më e përshtatshme dhe në shërbim të personave me aftësi të kufizuara. Mirëmbajtja e objektit është një element tjetër me rëndësi për produktivitetin e organizatës e për të cilën duhet kërkuar ndihmë nga Komuna. Përveç aspektit infrastrukturor, Komuna ka obligime ligjore të tjera për t'i mbështetur shërbimet sociale për persona me aftësi të kufizuara. Për këtë arsye është me rëndësi monitorimi i punës së komunës dhe përfshirja sa më e madhe e Handikos Ferizaj në politik-bërje dhe planifikim të buxhetit të komunës.

Zhvillimi i iniciativave për ndërmarrësi sociale është një mundësi tjetër e mirë për diversifikim të fondeve. Iniciativa të tilla, kur janë mirë të realizuara, kanë efekt të shumëfishtë, meqë ndikojnë gjithashtu në rritjen e punësimit, integrimin e personave dhe ndërgjegjësimin e shoqërisë. Zhvillimi i një programi të tillë nga ana e Handikos Ferizaj do të planifikohet me kujdes dhe në konsultim të gjerë me partnerët e organizatës dhe ekspert të fushës.

Së fundi, duhet parë mundësinë për futjen e pagesës për anëtarët që përfitojnë nga shërbimet e ofruara, qoftë kjo fillimisht edhe në formë simbolike. Pagesa për shërbimet e ofruara gjithashtu mund të krijoj një dinamikë të re pozitive, ku përfituesit do të jenë më të interesuar ndaj punës së organizatës dhe cilësisë të ofruar. Kjo në kthim e bën organizatën edhe më të përgjegjshme dhe më vigjilente në punën e saj.

8. Monitorimi dhe Vlerësimi

Handikos Ferizaj do të ketë planin për monitorim dhe vlerësim i cili ndër të tjera do t'i përcaktoj mekanizmat për monitorim, treguesit (indikatorët) në nivel të objektivave strategjike, nën-objektivave dhe aktiviteteve. Gjithashtu, plani do të përcaktoj qartazi përgjegjësitë e stafit dhe menaxhmentit në mënyrën e mbledhjes – dhe llojit - të informatave. Në rast nevojë, Handikos Ferizaji do të kërkojë këshilla nga anëtarë të bordit apo partner të saj, të cilët mund të ndihmojnë në përpilimin e një plani të mirëfilltë të monitorimit dhe vlerësimit.

Monitorimi dhe vlerësimi është mekanizëm kyç që do të mundëson matjen e progresit në implementimin e planit strategjik të organizatës, gjegjësisht do të na lejon të vlerësojmë punën e organizatës; na ndihmon të shohim nëse mënyra në të cilën po veprojmë është duke na dhënë rezultatet e kërkuara, nëse duhet ndryshuar diçka apo nëse burimet janë të mjaftueshme. Mbi të gjitha, janë përfituesit dhe anëtarët ata të cilët do të përfitojnë nga një qasje më efektive dhe shërbime më të përsosura të organizatës.

Prandaj në fund të çdo viti kalendarik do të bëhet rishikimi i strategjisë nga bordi dhe menaxhmenti i organizatës për të vlerësuar arritjet, ngecjet, pengesat në procesin e zbatimit të strategjisë dhe do të hulumtohen mënyra alternative për t'i tejkaluar këto të fundit. Në bazë të kësaj analize, pastaj përpilohet plani i veprimtë për vitin që pason.

9. Rritja e vizibilitetit

Handikos Ferizaj gëzon një imazh të mirë mirëpo ka nevojë të rrisë vizibilitetin e punës së saj në mënyrë që palët e interesit - përfituesit, anëtarët, partnerët, donatorët dhe shoqëria në përgjithësi - të jenë në rrjedhë me punën e organizatës. Përveç informimit, rritja e vizibilitetit ka efektin e dyfishtë të rritjes së vetëdijes të shoqërisë.

Për këtë arsye do të përpilohet një plan komunikimi në bashkëpunim me një ekspert të kësaj fushe, ku sqarohen veprimet konkrete të organizatës në këtë aspekt dhe kur duhet ndërmarrë ato. Ky plan, të paktën duhet të përmbajë protokollet e komunikimit me jashtë, kanalet më të mira të komunikimit në media sociale dhe media tradicionale, llojin e fushatave që duhet zhvilluar, shkrimet dhe/apo botimet për tu publikuar (si artikuj në media apo blog, raporte vjetore, tregime suksesi etj.) dhe mekanizmat për monitorimin dhe vlerësimin e efikasitetit të veprimeve të lartpërmendura.

10. Infrastruktura

Handikos Ferizaj duhet shqyrtuar mundësitë për zgjidhje afat-gjate të hapësirave ku vepron. Kjo është një çështje që duhet parë në bashkëpunim me Komunën e Ferizajit. Hapësira duhet të jetë e përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve ditore dhe lehtë e qasshme për personat me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, organizata duhet të jetë lehtë e identifikueshme nga jashtë, andaj duhet të ketë shenjëzim adekuat.

Mirëmbajtja e rregullt objektit është një element tjetër me rëndësi për produktivitetin e organizatës e për të cilën duhet gjetur zgjidhje të shpejtë, me ndihmë nga Komuna.

11. Korniza Ligjore

- Ligji për të Drejtat dhe Statusin e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik;
- Ligji për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë - Nr. 2003/23;
- Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës - Nr.04/L-032;
- Ligji për Përkrahjen Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme - Nr.03/L-022;
- Ligji për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi Të Kufizuar - Nr. 03/L-019;
- Ligji për Personat e Verbër - Nr. 04/L-092.

Ligjet që përmbajnë provizione relevante për personat me aftësi të kufizuar janë:

- Ligji i Punës - Nr. 03/L-212;
- Ligji për Tatimin në të Ardhurat Personale - Nr.05/L-028
- Ligji për Shëndetësi Nr.04/L-125
- Ligjit kundër Diskriminimit - Nr. 2004/3;
- Ligji për Skemën e Asistencës Sociale - Nr. 2003/15;
- Ligji mbi Ndërtimin - Nr. 04/L – 110;
- Ligji për Sportin Nr.04/L-075
- Vendimi për Gjuhën e Shenjave - Nr. 06/146.
- Udhëzimi Administrativ për Menaxhimin e Materialit të Inkontinencës Urinare për Personat me Aftësi të Kufizuara - Nr. 03/2012;
- Udhëzimi Administrativ për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasje të Personave me Aftësi të Kufizuar - Nr. 07/2007;
- Udhëzimi Administrativ për Procedurat e Aplikimit për Njohjen e të Drejtave për Aftësim, Riaftësim dhe Punësim të Personave me Aftësi të Kufizuar Nr. 03/2010
- Kodi Doganor dhe i Akcizave të Republikës së Kosovës - Nr.03/L-109
- Rregullorja Nr. 2000/66 mbi Beneficionet e Invalidëve të Luftës të Kosovës dhe për më të Afërmit e Tyre që Kanë Vdekur si pasojë e Konfliktit të Armatosur në Kosovë;

Strategjitë relevante janë:

- Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës 2013 – 2023;
- Plani Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar 2017-2019
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës 2016 – 2022;
- Plani Strategjik për Arsimin e Kosovës 2017 – 2021;
- Programi Kombëtar për Ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave për Personat e Shurdhër në Republikën e Kosovës 2013 – 2016;
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016 – 2021